

VENDIM
Nr.311, datë 5.5.2010

**PËR PËRCAKTIMIN E AFATIT, TË PËRMBAJTJES DHE TË MËNYRËS SË
NJOFTIMIT PUBLIK PËR PROCEDURAT E KALIMIT TË SË DREJTËS SË
PRONËSISË MBI TRUALLIN SHTETËROR, NË ZONAT ME PËRPARËSI TURIZMIN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr.10186, datë 5.11.2009 “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) bën njoftim publik për dokumentet dhe procedurat e nevojshme për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin, për 20 ditë:

- a) në 2 gazetat me qarkullim më të madh në vend;
- b) në Televizionin Publik Shqiptar dhe në 2 televizione kombëtare;
- c) në faqen zyrtare të internetit të ALUIZNI-t.

2. Njoftimi publik përmban:

a) afatin brenda të cilit subjekti i interesuar dhe personi i stimuluar duhet të paraqesin dokumentet pranë ALUIZNI-t, sipas ligjit nr.10186, datë 5.11.2009 “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”;

b) llojin e dokumenteve që duhet të paraqesë subjekti i interesuar/personi i stimuluar;

c) masën e tarifës që duhet paguar.

3. Efektet financiare të njoftimit publik përballohen nga buxheti i ALUIZNI-t.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha